



REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi dhe nenin 23 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit nga parashtrues i njohur, në vazhdimi i seancës së vazhduar së 50-të, të mbajtur më datë 22.007.2021 morri;

VENDIM

Denoncimi me numër 12-5028 / 1 i datës 30.10.2019 i dorëzuar nga parashtrues i panjohur **REFUZOHE**T.

Denoncimi i dorëzuar nuk përmban elemente me pohime konkrete për rrezikimin e interesit publik për shkak të veprimeve të personave zyrtar në kryerjen e autorizimeve publike dhe detyrave zyrtare.

Lënda me numër 12 -5028 e vitit 2019 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Lënda me numër 12-5028 / 1 të datës 2019 është formuar në bazë të denoncimit/informacionit me nr. 12-5028/1 të datës 30.10.2019 nga parashtrues i panjohur (denoncim anonim).

Me denoncim shprehet pakënaqësi për punën e Kryetarit të Komunës ----- për të cilën, siç thuhet në denoncim, me disa procedura dhe veprime që ai bën me materialin sfond dhe pasuron veten dhe rrethin e tij të njerëzve përreth tij".

Në denoncim theksohen dyshime se në Komunë ----- leje ndërtimi ka marrë vetëm një person----- (nuk është theksuar mbiemri i personit) nga fshati ----- për të cilën te denoncuesi ekziston dyshim se ka regjistruar kompani ,, ----- ", i cili person përsëri kishte një marrëdhënie të ngushtë familjare me V.D. udhëheqës i sektorit për urbanizëm në komunë, se eksiton shmangie nga "miratimi i dhënë për ndërtim në rr. -----" për të cilat janë vënë në dukje si përgjegjëse V.D. udhëheqësi i sektorit për urbanizëm në Komunë ----- si dhe Kryetari i Komunës ----- . Denoncuesi kërkon ekzaminimin e shpenzimeve komunale për transportin e nxënësve të shkollave të mesme në -----, për të cilat ai tregon ekzistencën e një marrëveshjeje, pa treguar personin juridik për të cilin, siç i kishin thanë se ka informacion për

shtyrjen e pretenduar të pagesave, me qëllim të përfitimit (përçindje), për të cilën vetë denoncuesi pajtohet se është e vështirë të vërtetohet.

Gjithashtu pa specifikuar emrin dhe mbiemrin, por vetëm me përshkrim, pohon se punonjësit në komunë të cilët janë të përfshirë në procesin e legalizimit të objektit, punonjës që kanë marrë rrogë nga Komuna ----- - ishin jashtë vendit (Gjermani, Kuvajt), më tej, parregullsi të tjera në punën e sektorit të financave në lidhje me periudhën për vlerësimin e kontratave të shitjes, janë treguar indikacione të mundësisë së abuzimit në ndryshimin e shpejtë të planit të detajuar urbanistik në një vend aty pranë -----, pa dhënë të dhëna të sakta.

Në denoncim nuk ka pohime ose indikacione të qarta për veprime të paligjshme ose të palejueshme të personave zyrtarë në kryerjen e kompetencave publike dhe detyrave zyrtare, për shkak të të cilave Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E
KORRUPSIONIT
Kryetar,
Biljana Ivanovska

Dorëzuar deri te:

Arkivi

Punoi: KZ, Këshilltar

Miratoi: K:N, anëtar i KSHPK - së

